



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS ISTOG

Numri i lëndës: 2022:184783

Datë: 14.05.2024

Numri i dokumentit: 05788008

**P.nr.262/22**

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË – DEGA NË ISTOG, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal**, Gjyqtari i vetëm gjykues Petrit Nrecaj, me procesmbajtësen Hale Ahmetaj, në çështjen penale kundër të pandehurës M.B-H, për shkak të veprës penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 370 par. 8 lidhur me par.1 dhe 6 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (tutje KPRK), e akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë – Departamenti i Përgjithshëm PP/II.nr.804/22 e datës 16.09.2022, pas mbajtjes së seancës publike të shqyrtimit fillestar më datë **16.04.2024**, në prezencën e Prokurorit të Shtetit Sadije Muriqi dhe të pandehurës M.B-H se bashku me mbrojtësin e saj av. Getuar Zekaj, të caktuar sipas detyrës zyrtare, të njëjtën ditë mori dhe shpalli, ndërsa me datë 14.05.2024, përpiloi, këtë:

## A K T G J Y K I M

### **E pandehura:**

M.B-H, nga i ati A dhe e ëma H. e gjinisë H., e lindur me datë ... në fshatin U., Komuna I., tani me banim në P., rr. “K.F”, nr.21, gjithashtu me vendbanim edhe në shtetin e Z., në qytetin B., e martuar, nënë e katër fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, me profesion rrobaqepëse, me gjendje të mesme ekonomike, me numër personal ... shqiptare, shtetase e Republikës së Kosovës dhe e Zvicrës.

## ËSHTË FAJTORE

### **Sepse:**

Me datë 08.04.2022, rreth orës 09:30 minuta, në fshatin Gurrakoc, Komuna Istog, nga pakujdesia ka shkelur nenin 53 të Ligjit për Rregullat e Trafikut Rrugor, në atë mënyrë që përderisa e pandehura po qarkullonte me veturën e saj të tipit “VW Passat 3BG”, me targa të regjistrimit 03-811-DI, duke mos e përshtatur shpejtësinë e lëvizjes në raport me kushtet e rrugës dhe rrethanat e rrugës, nuk kishte arritur të mbaj shiritin e saj qarkullues me ç’rast me pjesën e parë të automjetit kishte kaluar një (1) metër në anën e kundër të qarkullimit, ku me pjesën e majtë të

përparme të automjetit e kishte goditur në pjesën e majtë anash automjetin WV Golf me targa 01-222-AF, të cilin po e drejtonte i dëmtuari B.I, ku si pasojë e goditejës e pandehura me veturën e saj kishte shkuar për 74 m e 50 cm, deri sa ishte ndalur në shiritin qarkullues Mitrovicë-Pejë, ndërsa i dëmtuari me veturën e tij ishte bartur dhe kishte shkuar në anën e majtë rreth 28m e 70 cm, duke kaluar jashtë rrugës në drejtimin Pejë-Mitrovicë, e si pasojë e aksidentit sipas raporteve mjekësore dhe ekspertizës mjeko ligjore të punuar për rastin, lëndime të rënda trupore ka pësuar e dëmtuara-pasagjerja M.I, si dhe janë shkaktuar dëme materiale ne të dy automjetet.

- me çka ka kryer veprën penale **rrezikim i trafikut publik nga neni 370 par. 8 lidhur me par.1 dhe 6 të KPRK-së.**

Gjykata duke u bazuar në nenin e lartcekur dhe dispozitat e nenit 2, 4, 7, 17, 21, 38, 40, 42,46, 47, 48, 49, 69, të KPRK-së dhe nenit 242, 364, 459 të Kodit të Procedurës Penale (tutje KPP-së), të pandehurën e:

## GJYKON

- I.** Ashtu që, të pandehurës **M.B-H**, i shqiptohet dënimi më burgim në kohëzgjatje prej shtatë (7) muajve, *i cili dënim do të jetë i kushtëzuar, nuk do të ekzekutohet* nëse e pandehura brenda periudhës së verifikimit në kohëzgjatje prej një (1) viti, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryen vepër tjetër penale.
  - **Në të kundërtën**, nëse e pandehura brenda periudhës së lartcekur të verifikimit kryen vepër tjetër penale, atëherë gjykata në bazë të nenit 50 të KPRK-së, do t'a revokon dënimin me kusht dhe ndaj personit të dënuar do të ekzekutohet dënimi me burgim.
- II.** Gjykata, të pandehurës **M.B-H**, i shqipton edhe **DËNIM PLOTËSUESES, ndalimi i drejtimit të automjetit**, ashtu që, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi i ndalohet drejtimi i automjetit për kategorinë "B", në kohëzgjatje prej një (1) viti. **Këtë dënim plotësues duhet t'a ekzekutoj Policia e Kosovës – Njësia Rajonale e Komunikacionit Rrugor në Pejë (NjRKRR).**
- III.** **OBLIGOHET** e pandehura që në emër të shpenzimeve të procedurës penale, të paguaj për ekspertizën mjeko-ligjore shumë prej **dyzet (40) euro**, për ekspertizën e komunikacionit shumë prej **dyzet (40) euro**, paushallin gjyqësor në shumë prej **njëzet (20) euro**, ndërsa në emër të taksës për programin për kompensimin e viktimave të krimit shumë prej **njëzet (20) euro**, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
- IV.** **Pala e dëmtuar:** M I dhe B.I me banim në kompleksin "Arra" nr.11, Komuna D., për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet ne kontest te rregullt juridiko civil.

## A r s y e t i m

### Rrjedha e procedurës penale

Në këtë gjykatë, Prokuroria Themelore në Pejë - Departamenti i Përgjithshëm ka ngritur aktakuzën PP/II.nr.804/22 e datës 16.09.2022, kundër të pandehurës M.B-H për shkak të veprës penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 370 par. 8 lidhur me par. 1 dhe 6 të KPRK-së.

Gjykata në këtë çështje penale, ka caktuar dhe mbajtur shqyrtimin fillestar me datë 16.04.2024 në të cilën seancë kanë prezantuar Prokurori i Shtetit Sadije Muriqi dhe e pandehura M.B-H se bashku me mbrojtësin e saj av. Getuar Zekaj, të caktuar sipas detyrës zyrtare, ku pas leximit të aktakuzës nga Prokurori i Shtetit, gjykata pasi që është bindur se e pandehura e ka kuptuar akuzën, dhe pas njoftimit me benifitet dhe pasojat e pranimit të fajësisë, i ka mundur të pandehurës të deklarohet për pranimin e fajësisë apo të deklarohet e pafajshme.

**E pandehura M.B-H**, pas konsultimit me mbrojtësin e saj av. Getuar Zekaj, lidhur me fajësinë, ka deklaruar se: e pranon fajësinë për shkak të veprës penale për të cilën akuzohet, është e vetëdijshme për pasojat e pranimit të fajësisë pranimin e fajësisë e ka bërë në mënyrë vullnetare dhe pa presion nga askush, duke shtuar se është penduar për këto veprime, kjo vepër penale ka ndodhur nga pakujdesia dhe i premtoj gjykatës se ne të ardhmen do të jem e kujdesshme në komunikacion dhe nuk do të kryej vepra penale.

**Prokurori i shtetit**, lidhur me pranimin e fajësisë nga e pandehura, ka deklaruar: pajtohem me pranimin e fajësisë të deklaruar nga ana e të pandehurës për veprën penale e cila i bije në barrë, i njëjti është bërë në mënyrë vullnetare dhe pa ndonjë presion dhe pas konsultimit me mbrojtësin e saj, dhe gjen mbështetje edhe në shkresat e lëndës.

**Mbrojtësi i të pandehurës M.B-H, av. Getuar Zekaj**, lidhur me pranimin e fajësisë nga e pandehura ka deklaruar: se pajtohem me pranimin e fajësisë nga ana e të mbrojturës sime, gjykatës me rastin e shqiptimit të dënimit i kërkoj që të marr parasysh këto rrethana lehtësuese pranimin e fajësisë prej fillimit të procedurës, bashkëpunimin me organet kompetente, ndjesinë e kërkuar ndaj palëve të dëmtuara, të këtë parasysh se është nënë e dy fëmijëve, si dhe duke marrur parasysh edhe faktin se njëri nga fëmijët vuan edhe nga të metat përkatësisht ngecje në zhvillim, andaj duke iu referuar të lartcekurave kërkoj nga gjykata që të njëjtës t'i shqiptoj një dënim sa më të butë me të cilin do të arrihet edhe qëllimi i dënimit siç parashihet me nenin 38 të KPRK-së.

### Vlerësimi i pranimit të fajësisë

Gjykata ne rastin konkret lidhur me pranimin e fajësisë nga e pandehura, pas marrjes së mendimeve të lartcekura, si dhe pas vërtetimit se janë përmbushur kërkesat nga neni 242 par. 1, 2, nën par. 2.1, 2.2, dhe 2.3 të KPP-së, përkatësisht pas vlerësimit se e pandehura e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, se ky pranim është bërë në baza vullnetare dhe se mbështetet në faktet dhe provat që përmban aktakuza, po ashtu pas vërtetimit se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike të paraparë me nenin 248 par. 2, nën

par. 2.4 të KPP-së, gjykata ka pranuar pranimin e fajësisë nga e pandehura për veprën penale të lartcekur për të cilën është akuzuar.

#### Vendimi për shpalljen fajtor

Gjykata nga të lartcekurat ka vendosur që të pandehurën t'a shpall fajtores për veprën penale për të cilën është akuzuar dhe e ka gjykuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi që gjeti se e njëjta është penalisht përgjegjëse dhe se nuk ekzistojnë rrethana të cilat e përjashtojnë përgjegjësinë penale të të pandehurës, po ashtu në veprimet e saj manifestohen të gjitha elementet subjektive dhe objektive të veprës penale të lartcekur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Pas pranimit të fajësisë nga e pandehura dhe konstatimit nga gjykata të përmbushjes së kushteve ligjore, gjykata ka vlerësuar se nuk është e nevojshme vërtetimi i ndonjë fakti relevant për shqiptimin e dënimit dhe për këtë arsye ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

#### Rrethanat që janë marre për bazë me rastin e matjes dhe shqiptimit të dënimit

Gjykata me rastin e marrjes së vendimit sa i përket sanksionit penal, përkatësisht me rastin e matjes dhe shqiptimit të dënimit, vlerësoi të gjitha rrethanat rënduese dhe lehtësuese, të cilat konform nenit 69 të KPRK-së, ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, ashtu që si **rrethana lehtësuese** ka gjetur se e pandehura e ka pranuar fajësinë, nuk ka qenë e dënuar me parë dhe rrethanat personale se është pënduar për veprën e kryer dhe kërkim faljen palës së demtuar; ndërsa **rrethana rënduese** gjykata nuk ka gjetur. Prandaj, në rastin konkret nga rrethanat e lartcekura, gjykata ka vlerësuar se dënimi i shqiptuar ndaj të pandehurës si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, është në proporcion me peshën e veprës penale, me sjelljen dhe rrethanat e kryesit, me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore dhe përgjegjësinë e kryesit, me bindje se dënimi i tillë do të ndikojë në risocializimin dhe riedukimin e këtij të pandehurit, i cili do ta kuptojë rëndësinë e veprës penale të cilën e ka kryer dhe në këtë mënyrë i njëjti do të reflektojë që në të ardhmen mos të shkaktoj veprime të ndaluara- përkatësisht mos të kryej vepra penale, si dhe do të ndikojë tek personat tjerë të mos kryejnë vepra penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, çka është edhe qëllimi i dënimit konform nenit 38 të KPRK-së.

Sipas bindjes së gjykatës, dënimi me burgim në kohëzgjatje prej shatë (7) muajve i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse e pandehura në afat prej një (1) viti, nga dita kur ky aktgjykim merr formën e prerë, nuk kryen veprë të njëjtë apo tjetër penale. Është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurës, me të cilin dënim do të arrihet edhe qëllimi i dënimit me kusht sipas nenit 47 të KPRK-së, përkatësisht që të mos zbatohet dënimi për vepra penale kur vlerësohet se tërheqja e vërejtjes me kërcënimin e dënimit është e mjaftueshme të ndalojë që kryesi të mos kryejë vepra penale.

#### Vendimi për dënimin plotësues

Gjykata konform dispozitave ligjore të nenit 59 par. 2 nënpar.2.5 dhe nenit 64 par.2 të KPRK-së, të pandehurës i shqiptoi dënimin plotësues ndalimi i drejtimit të automjetit në periudhën kohore të përcaktuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për faktin se ka paraqitur rrezik të lartë tek pjesëmarrësit tjerë në komunikacion, duke ju shkaktuar dëme materiale dhe lëndime të rënda

trupore, këtu palës se dëmtuar, siç përshkruhet në përshkrimin faktik të veprës penale të lartcekur në këtë aktgjykim.

*Shpenzimet e procedurës*

Gjykata duke vendosur lidhur me shpenzimet e procedurës, në kuptim të nenit 449 par. 2 dhe nenit 452 par. 1 të KPP-së, e ngarkoi të pandehurën me shpenzimet e procedurës, të precizuara si ne dispozitiv të këtij aktgjykimi, e po ashtu konform Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit, e obligoi të paguaj shumën prej 20 euro në emër të taksës për programin për kompensimin e viktimave të krimit.

*Udhëzimi i palës së dëmtuar për kërkesat pasurore-juridike*

Vendimi për udhëzimin e palës së dëmtuar për realizimin e kërkesave pasurore juridike në kontest civil, është marr konform nenit 457, 462 par.2 të KPP-së.

Gjykata duke u bazuar në arsyet e lartshënuara e në bazë të neneve 242, 364 dhe 369 të KPP-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË – DEGA NË ISTOG**  
**Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal**

**Procesmbajtësja**  
**Hale Ahmetaj**

**GJYQTARI**  
**Petrit Nrecaj**

---

**KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej tridhjetë (30) ditësh, llogaritur nga dita e pranimit të aktgjykimit. Ankesa dorëzohet përmes kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, *në kopje të mjaftueshme për palët dhe për gjykatën.*